

SHOQËRIA RAJONALE UJESJELLES KANALIZIME BERAT SH.A

Nr. ____ Prot.

Berat, më ____/____/2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Blerje Hipoklorit Kalciumi dhe Natriumi .

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

KLOR-24311900-6

VLERA E FONDIT LIMIT: 5,843,667 (Pesëmilion e tetëqinde e dyzet e tremijë e gjashtëqind e gjshtëdhjetë e shtatë) leke pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME, BERAT SH.A, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 8

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas percaktimeve të bëra në Shtojcën 7 të DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit**).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2020, 2021, 2022) të certifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, ndërsa kushti që bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar është vendosur në zbatim të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar.

2.2.2 Xhiroja vjetore e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3(tre) viteve të fundit (2020, 2021, 2022) të jetë jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit dhe kjo të jetë e vërtetuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shkresë ose me dokument të nxjerrë online me vulë elektronike. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës. Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike".

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2023 (ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar), duke paraqitur një vërtetim nga organet e

qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, vërtetimin nga organet e qeverisjes vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete.

Shënim: Ky kriter (2.2.3) do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE renditet i pari në vlerësim para publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2021 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kryer furnizime të ngjashme në një vlerë jo më pak se 20% të fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë; a) Kontrata të realizuara me autoritete kontraktore, të cilat duhet të jenë të shoqëruara me vërtetimin e realizimit me sukses të saj, lëshuar nga autoriteti kontraktor ku të shprehen qartë datat, shumat dhe furnizimet e realizuara ose vërtetimin për realizimin me sukses të kontratës shoqëruar me faturat tatimore të shitjes, ku të shprehen qartë datat, shumat dhe furnizimet e realizuara. b) Për furnizime të realizuara me subjekte private operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe furnizimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” në kushtet kur kjo procedurë prokurimi klasifikohet procedurë e hapur e thjeshtuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Në zbatim të nenit 55, pika 4/b në kushtet kur kjo procedurë prokurimi është procedurë e thjeshtuar të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.3.2 Me qëllim vërtetimin se produkti objekt prokurimi “Hipoklorit Natriumi”, është prodhuar nga prodhues të licencuar, dhe se është në përputhje me specifikimet teknike e standartet e kërkuara, Operatori Ekonomik (Ofertuesi) duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

1. Në rast se ofertuesi është vetë prodhues, duhet të paraqesë:

- Çertifikatën që vërteton konformitetin e produktit me standardin SSH EN 901: 2013 “Kimikate që përdoren për trajtimin e ujërave të destinuara për konsum njerëzor” - Leje mjedisore e tipit A të lëshuar nga Ministria e Mjedisit për kimikatin e kërkuar.

2. Në rast se ofertuesi nuk është vetë prodhues, duhet të paraqesë: - Autorizim të prodhuesit për ofertuesin ose autorizim për ofertuesin nga distributori i autorizuar prej prodhuesit ose që ka lidhur Marrëveshje Bashkëpunimi me prodhuesin (ose ekuivalenti i tij/saj) sipas ligjit. Gjithë këto dokumente duhet të kenë afat vlefshmërie për gjithë kohëzgjatjen e kontratës të kësaj procedure prokurimi, i cili duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Ku në rast se autorizimi është lëshuar nga distributori duhet të paraqitet edhe Autorizimi/ Marrëveshja e bashkëpunimit midis distributorit dhe prodhuesit, e cila duhet të jetë e vlefshme në datën e zhvillimit të tenderit.

- **Çertifikatën e origjinës**, cilësisë dhe Skedë teknike të lëshuara nga institucione të autorizuar ose nga prodhuesi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produktit të prodhuar me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara.

- **Lejen e importit** të lëshuar nga Komisioni i Licensave pranë Ministrisë së Shëndetësisë për llojin e kimikatis, në rast se ofertuesi është vetë importues, dhe në rast se nuk është vetë importues, duhet të paraqesë kontratën e furnizimit me një importues të këtij malli i cili disponon lejen e importit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në zbatim të ligjit nr.10138, datë 11.05.2009”Për Shëndetin Publik”, ligji nr.10081, datë 23.02.2009”Për licencat , autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, gjithashtu mbështetur edhe në pikën 1 të Vendimit nr. 415, date 17.08.1993 të Këshillit të Ministrave "Për licencimin eeksportit, importit dhe shitjes me shumicë dhe pakicë të substancave për desinfektim,dezinfektim dhe deratizim" parashikohet se: “Importimi, eksportimi, magazinimi dhe tregtimi me shumicë e pakicë i lëndëve dezinfektante, dezinfektante e deratizuese për persona komunal, në banesa dhe objekte të ndryshme sociale nga persona juridikë e fizikë, si dhe nga individë të ndryshëm, bëhet me leje (licencë) që jepet nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit.

Ky kriter është vendosur në mbështetje të vendimit nr. 379 date 25.05.2016 neni 14, pika 1 në të cilën sanksionohet: “Për trajtimin e ujit të pijshëm lejohet të përdoren vetëm lëndët kimike të miratuara/autorizuara sipas legjislacionit përkatës për produktet biocide” dhe kimikatet objekt prokurimi (produkte biocide) që u lejohet leja e importit janë të përcaktuara në urdhërin nr.202 date 23.05.2014 nga Ministria e Shëndetësisë “Për autorizimin e importit

të produkteve biocide dhe miratimin e listës së produkteve biocide për dezinfektimin, deratizimin dhe dezinfektimin në Shëndetin Publik dhe produkteve për trajtimin e ujit të pijshëm të lejuara për tregtim dhe përdorim në Republikën e Shqipërisë.

Referuar vendosjes të lejes mjedisore të tipit A në rastin kur operatori ekonomik është prodhues vendas apo kur operatori ekonomik është tregtues vendas kriteri është vendosur në zbatim të ligjit nr. 10 448, datë 14.7.2011”Për lejet e mjedisit” të ndryshuar.

Në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011”Për lejet e mjedisit” parashikohet se

“Leje mjedisi e tipit A” është leja për veprimtaritë e përcaktuara në aneksin 1/A, e përgatitur nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe e firmosur nga ministri, të lëshuar nga QKL-ja, që i jep të drejtën e funksionimit, tërësisht ose pjesërisht, instalimit të tipit A, sipas përcaktimit të këtij ligji, dhe që përmban të shkruara kushtet e nevojshme për të garantuar se instalimi përmbush kërkesat e këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi. Një leje mund të mbulojë një ose më shumë instalime ose pjesë të instalimeve në të njëjtën vendndodhje dhe që operohen nga një i njëjti operator.

Në aneksin 1/A parashikohet shprehimisht veprimtaria “Prodhimi i kimikateve inorganike bazë (4.2)”.

Përderisa tipi i lejes A përfshin në veprimtarinë e saj “Prodhimi i kimikateve inorganike bazë (2)” atëherë domosdoshmërisht operatori ekonomik prodhues i interesuar për procedurën objekt prokurimi duhet të jetë i licënsuar për prodhimin e kimikateve inorganike bazë me qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi.

Sa më sipër në vlerësimin e Autoriteti Kontraktor ky kriter ligjor është i domosdoshëm pasi objekti i prokurimit për vetë natyrën e tij ka një impakt social të rëndësishëm pasi bëhet fjalë për ujin e pijshëm ndaj edhe garancitë që Autoriteti Kontraktor synon të përftojë me anë të vendosjes së kriterëve duhet të jenë të një niveli të lartë për të konkluduar me përmbushjen e suksesshme të kontratës objekt prokurimi.

2.3.3 Operatori ekonomik për Hipoklorit Natriumi 12-15%”, duhet të ketë në pronësi ose me qera ose Huapërdorje 1 mjete (autobot) të autorizuar për transport kimikatesh.

Për të vërtetuar disponimin e mjeteve të kërkuara më lart operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

a)Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi) për “Transport lende të rrezikshme” ,lejen e qarkullimit, plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme) dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(te vlefshme), duhet të shoqerohet me kontratën perkatese të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

b)Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.

c)Për mjetet e marra me qera ose me huapërdorje të paraqitet kontrata përkatëse e qirasëose te huapërdorjes ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.

d)Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për mjetet e deklaruar ku të jenë të dukshme dhe targat e mjetit.

e) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë në sistemin elektronik se disponon mjete për të realizuar kontratën objekt prokurimi.

Shënim: Për pikat (2.3.3) më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.8.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te dorezojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit** , të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore” (të ndryshuar), Udhëzimi Nr.15, datë 24.7.2007 ”Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor” me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate janë furnizimi në mënyrë periodike i një sasive të konsiderueshme mallrash specifike dhe me funksione speciale, automjeti i mësipërm konsiderohet i domosdoshëm pasi duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj dhe vendodhjen e objektit në të cilin do të kryhen furnizimet, i shërben Autoritetit Kontraktor për t’u bindur me kapacitetet teknike të ofertuesve me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës. Furnizimi me kimikate do të kryhet me automjet të certifikuara për transportin e lëndëve të rrezikshme. Automjeti për transportin e kimikateve duhet të jenë të përshtatëshme për të mbajtur prodhim të destinuar për trajtimin e ujit të pijshëm. Ato nuk duhet të kenë transportuar më parë substanca të dëmshme ose të konsideruara si të tilla për ndotjen e ngarkesës së kimikatit.

Githashtu referuar specifikimeve te administruar ne dosjen e procedures janë përcaktuar përvec furnizimit të mallit objekt prokurimi do të kryhet transporti dhe vendosja e tyre pranë vend-dorezimit te tyre ne destinacionin perkates .

Pra për këtë arsye është e domosdoshme që operatorët e mundshëm ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi mbi pajisjet teknike që kanë në dispozicion për të përmbushur kontratën objekt prokurimi.

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit, si dhe të gjitha shpenzimet e parashikuara në shtojcën 5 të specifikimeve teknike

(Shënim: Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit, mund të përcaktojë kriteret e tjera të vecanta, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, duke argumentuar teknikisht dhe ligjërishit çdo kriter, duke përcaktuar, sipas rastit, aktin ligjor/nënligjor që parashikon domosdoshmërinë e kriterit në fjalë)

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

a) Të disponojë Çertifikatën mbi “Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë” ISO 9001:2015 (ose ekuivalente) e vlefshme. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre përsipër sipas akt-marreveshjes).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë i plotësojnë kërkesat e cilësisë, e rrjedhimisht është e drejtë e AK t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencen/profesionalizmin e punonjësve, procesi i menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktimi i specifikimeve teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke***

argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent”.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve hartohet bazuar ne nevojen qe ka institucioni per kete produkt:

Specifikimi i Materialeve hartohet bazuar ne nevojen qe ka institucioni per kete produkt:

Informacioni në lidhje me specifikat kryesore për Hipokloritin e Natriumit:Treguesit e cilësisë dhe karakteristikat kimike të produkteve të ofruara nga firmat konkruese duhet të plotësojnë parametrat e cilësisë dhe sigurisë si më poshtë

Nr.	Parametrat	Njësia e matjes	Specifikat Kimike
1	Gjëndja	-	Lëng i kthjellët
2	Ngjyra	-	E Verdhë e çelët
3	Densiteti në 20°C	gr/ml	1.13 - 1.28
4	Titulli i Cl2	%	12 - 15
5	Substanca Toksike	mg/kg	Limitet në mg/kg të klorit të lirë

Çdo parti klori e ardhur në Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Berat Sh.a. do të shoqërohet me fletë analizën të cilat kyen nga laboratorit të Drejtorisë së Shëndetit Publik (I.SH.P.),

Hipoklorit kalciumi. {*Calcium hypochlorite (Ca(OCl)₂* CAS no.7778-54-3} në përqendrim 60%-70%; ky preparat duhet të jetë në përputhje me parametrat e Komunitetit European (CE) dhe të shërbejë për dezinfektimin e ujrave. Paketimi: Në konfeksion plastik 23kg-50kg. Jetëgjatësia: jo më pak se një vit nga data e lëvrimit.

Argumentimi:Specifikimet janë hartuar në përputhje me Standartet Shtetërore Shqiptare përkatëse konkretisht : Hipokloriti i Natriumit S SH EN 901: 2013

Hipoklorit kalciumi. {*Calcium hypochlorite (Ca(OCl)₂* CAS no.7778-54-3} në përqendrim 60%-70%; ky preparat duhet të jetë në përputhje me parametrat e Komunitetit European (CE) dhe të shërbejë për dezinfektimin e ujrave. Paketimi: Në konfeksion plastik 30kg-50kg. Jetëgjatësia: jo më pak se një vit nga data e lëvrimit.

Hipoklorit Kalciumi (ne mg/kg te klorit aktiv 60-70 %)

Nr.	Parametrat	Njësia e matjes	Specifikat Kimike
1	Gjëndja	-	Granular
2	Ngjyra	-	E bardhe e hapur
3	Titulli i Cl ₂	% m/m	60 - 70
4	Kadmium (Cd)	mg/kg	max 5
5	Krom (Cr)	mg/kg	max 2.5
6	Nikel (Ni)	mg/kg	max 20
7	Plumb (Pb)	mg/kg	max 20

Afatet e lëvrimit:

Artikulli	Përshkrimi	Shuma	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
1	Hipoklorit Kalciumi 60-70%	26 200	SHRUKB	12 muaj / 13100 kg brenda 30 ditëve nga nenshkrimi i kontrates dhe

				13100 kg pas 7 muaje nga nenshkrimi i kontrates
2	Hipoklorit Natriumi 12-15%	11 200	SHRUKB	12 muaj / 2000/l cdo 2 muaj

Raport analiza duhet të shoqërojë produktin për sasi të kërkuar sipas lëvrimit periodik.

Kontrolli i cilësisë dhe sasisë e ngarkesave të kimikateve

Në ditën e dorzimit të ngarkesës, do të merren nga ngarkesa me përzgjedhje të paktën 3 kampione të cilat do të futen në enë të përshtatshme, të sjelle nga furnitori dhe do të vulosen dhe firmosen nga marrësi dhe transportuesi, nga të cilat një do të dorëzohet nëpërmjet autotransportuesit firmës furnizuese dhe 1 në laboratorin e njesise vendore te kujdesit shendetesore Berat;

Njëra nga kampionet do të ruhet për kontrollin e analizës përfundimtare në rast kundërshtish nga ana e furnitorit. Në një situatë të tillë të dy palet do të ndjekin bashkarisht kontrollin e analizave pranë laboratorit të njesise vendore te kujdesit shendetesore Berat mbi kampionin e trete të vulosur si dhe mbi atë të firmës furnizuese në qoftë se mbi të nuk është vënë dorë, e ti nënshtrohen marrëveshjes së arsyeshme.

Firma furnizuese që nga momenti kur në mënyrë të verbalizuar është lajmëruar për faktin e mospërputhjes së cilësisë së ngarkesës me specifikimet teknike në përputhje me të cilat ka fituar garën, ka 3 ditë pune kohë për të prezantuar kundërshtitë e veta, në të kundërt e humb këtë të drejtë.

Në se firma furnizuese e prezanton kundërshtinë e saj në lidhje me rezultatin ose kontrollin e kryera nga laboratorin e njesise vendore te kujdesit shendetesore Berat brenda 3 ditë pune të marrjes së njoftimit verbal për mos përputhjen e ngarkesës, ajo ka një hapësirë kohore prej 5 ditë nga dita e komunikimit verbal për mos përputhjen e ngarkesës, për të bërë analizat në laboratorin e njesise vendore te kujdesit shendetesore tjetër e shoqëruar me një përfaqësues nga SHRUK Berat.

1. Grafiku i furnizimit, dhe oraret e dorëzimit të ngarkesave

Dërgimet e ngarkesave do të bëhen në bazë të një programi, 2000 l cdo dy muaj 2 e ndare 1500 litra do të depozitohet në Njesin Dimal dhe 500 litra në Njesin Skrapar për lenden Hipoklorit Natriumi 12-15% , që Drejtori i Shoqëris Rajonale Ujshelles Kanalizime Berat do t'ja parashtojë firmës kontraktuese me shkresë ose me email të paktën 5 ditë më parë duke përjashtuar rastet e veçanta e të pa parashikueshme kur periudha e mësipërme mund të ulët deri në 3 ditë dhe lajmërimi mund të bëhet edhe me telefon. Kërkesa për kimikate do të bëhet në sasi të dhe datat që do të jetë e nevojshme, kjo do të thotë se ka mundësi që sasi të mujore dhe datat e furnizimit me

kimikatat e kërkuara të jetë pak te ndryshme ose të ndryshme krahasuar me grafikun e bashkëlidhur i cili është paraprak dhe orientues.

Dorëzimi i ngarkesave se Hipoklorit Kalciumi 60-70% te behet ne magazines se institucionit 2 here,pra 13100 kg brenda 30 ditëve nga nenshkrimi i kontrates dhe 13100 kg pas 7 muajesh nga nenshkrimi i kontrates deri ne perfundimin e plot te sasis ne Adresen Lagja nr.1 Rruga Antipatrea Berat nga e hëna deri të premte, nga ora 8.00 deri në orën 15.00.

Per Dorëzimi i ngarkesave se Hipoklorit Natriumi 12-15% te behet ne magazines se institucionit muaj cdo 2 muaj ne sasin 500 litra ne prane magazinave te ujesjellesit Njesia Çorovod me Adrese: Lagja Estref Caka rruga e Deshmoreve Corovod nga e hëna deri të premte, nga ora 8.00 deri në orën 15.00 dhe ne sasin 1500 litra prane magazinave te ujesjellesit Njesia Dimal me Adrese:Lagja Guri i Bardhe Dimal nga e hëna deri të premte, nga ora 8.00 deri në orën 15.00 deri ne furnizimin e plote te sasise .

Të gjitha shpenzimet duke përfshirë ato të peshimit, të transportit dhe shkarkimit të kimikateve në magazinën e institucionit ne Adresen: Lagja nr.1 Rruga Antipatrea Berat, prane magazinave te ujesjellesit Njesia Skrapar me Adrese: Lagja Estref Caka rruga e Deshmoreve Corovod , prane magazinave te ujesjellesit Njesia Dimal me Adrese: Lagja Guri i Bardhe Dimal si dhe të analizave që do të bëhen përkatësisht për çdo ngarkesë dhe parti malli pranë Inspektoriatit Sanitar Shtetëror dhe Institutit të Shëndetit Publik do të jenë në ngarkim të firmës fituese. Ky procesverbal pasi u lexua dhe u konfirmua nga të pranishmit, u firmos pa pretendime.

Ky procesverbal pasqyrohet tek dokumentat standarte te tenderit.

KOMISIONI NJESIA E PROKURIMIT

Ervin Spahiu

Evis Allajbe

Gentian Merdani

MIRATOHET

Titullari i Autoritetit Kontraktor

Administratori

Pelivan Sinaj